

AKT - THEMELIMI
I
SHOQERISE
"WONDER POWER" SHA.



Neni 1

Ne baze te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise ,te ligjit Nr.7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", te ligjit 7667 dt 28.01.1993 "Per regjistrimin e shoqerive ne regjistrin tregtar", Ligjit Nr.7973, date 26.07.1995, "Per koncesionet dhe pjesemarrjen e sektorit privat ne sherbimet publike dhe infrastrukture", VKM. Nr. 390 date 12.06.2003, " Per fillimin e procedures se dhenies me koncesion, te formes "ROT", te Hidrocentralit te Bogoves, ne Skrapar, si dhe te Marreveshjes Koncesionare per marrjen me koncesion te HEC Bogove, lidhur midis OSHA (Ministrise se Industrise dhe Energjitikes, dhe Ministrise se Ekonomise) dhe "Wonder" Sha., date 07.08.2003, sot me date 219/ 2003, Zoti Vasil Gjika, ortak i vetem i kesaj shoqerie, i biri i Nikos, i datelindjes 19.02.1955, i lindur ne Permet, banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes nr. 0165341, person madhor me zotesi te polote juridike per te vepruar, me vullnetin e tij te lire e te plote, nepermjet ketij akti ne emer te "Wonder" Sha., themelon sot me Z. Sadik Llapashtica, i biri i Rames, i datelindjes 20.01.1960, i lindur ne Fier, banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes nr. Z 0151776, Shoqerine "Wonder Power" Sha., sipas dispozitave qe rregullojne veprimtarine e shoqerive tregtare dhe kushteve te parashikuara me poshte.

Ata deklarojne se kane nenshkruar kete kontrate dhe kane rene dakort per krijimin e Shoqerise "Wonder Power" Sha., ne baze te ketij akti themelimi si dhe statutit, duke respektuar edhe kerkesat e legjislacionit shqiptar per shoqerit tregtare.

Neni 2 KRIJIMI I SHOQERISE

 Qelimi i krijimit të "Wonder Power" Sha., është marrja me konçesion dhe ushtrimi i veprimtarisë konçesionare gjatë gjithë periudhës konçesionare në HEC Bogovë të Rrethit Skrapar.

Neni 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

"Wonder Power" Sh.a., ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe /ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryej një shoqëri anonime në bazë të legjislatcionit shqiptar dhe,
në veçanti :

Prodhimi energjise elektrike duke shfrytëzuar burimet e energjise të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme, si ajo hidrike, diellore, e ërës, gjeotermale, e biomases ose biogazit si dhe energjia nga mbetjet urbane. Projektimi, dhe studimi i hidrocentraleve, termocentraleve apo impianteve të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjise që gjenden në natyrë dhe që janë të rinovueshme.

Ndërtimi i hidrocentraleve, termocentraleve apo impianteve të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjise që gjenden në natyrë dhe që janë të rinovueshme.

Operimi, shitja e energjise elektrike klienteve dhe blerja e energjise elektrike nga operatore të ndryshëm privat apo shtetëror brenda dhe jashtë vendit.

Transmetimi i energjise elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.

Përdorimin e sistemeve të linjave, strukturave mbështetëse dhe pajisjesh, transformuese e kontrolluese për transmetimin e energjise elektrike.

Operator i sistemit të transmetimit për të kryer aktivitetin e transmetimit të energjise elektrike dhe të dispeçerimit (axhustim ose rregullimi i prodhimit) të energjise elektrike sipas kërkesave të konsumit, në nivel kombëtar.

Shpërndarjen, transportin e energjise elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit, të mesëm dhe të ulët, duke patur parasysh shpërndarjen deri tek konsumatori i fundit.



Neni 4

Vendodhja e selise se Shoqerise

"Wonder Power" Sh.a. do ta kete seline e saj ne Tirane, Rruga "Ismail Qemali" Qendra e Biznesit Kati III-te, Pallati 11 kate, kati 3.

Ajo mund te hape edhe zyra perfaqesie, dege te krijoje filjale filjale dhe/ose te realizoje çdo lloj pjesmarrie te parashikuar nga ligji ne shoqeri te tjera, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise "Wonder Power" Sh.a

Kohezgjatja e veprimtarise se "Wonder Power" Sh.a. do te jete 30 vjet. Si dite e fillimit te aktivitetit te tij do te merret data e regjistrimit ne Gjykatën e Tiranës. Aksioneret e shoqerise kane te drejte te zgjasin kete afat.

Neni 6

Ortakët Themelues

Emri i Ortakeve	Adresa e Ortakeve
1. "Wonder" Sha. perfaqesuar nga Vasil Gjika	Rruga "Ismail Qemali" Qendra e Biznesit Kati III-te, Tirane
2. Sadik Llapashtica	Rruga "Ismail Qemali" Pallati 27/1, Shkalla 1, Ap.1, Tirane

Neni 7

Kapitali i shoqerise "Wonder Power" Sh.a

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2.000.000 (dymilion) leke. Kapitali ndahet ne 100 aksione, me vlere nominale 20.000 leke sejcili, teresisht i derdhur dhe i numeruar nga 1 deri ne 100.

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar e aksionereve eshte :

Nr.	Emri Mbledhri	Nr Aksioneve	Vlera Nominale	Kontributi ne Para
1	"Wonder"Sh.a	1 - 55	20 000	1.100 000 leke.
2	Sadik Llapashtica	56- 100	20 000	900 000 leke.

I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer në të holla (leke) në mënyrë të barabartë nga ortakët e shoqërisë.

Themeluesit aksionerë kanë të drejtë të zmadhojnë dhe zvogelojnë kapitalin e shoqërisë në para, në përputhje me statutin e "Wonder Power" Sh.a. Në këtë rast do të behen veprimet përkatëse për pjesëmarrjen e aksionerëve në kapitalin themeltar.

Neni 7

Vendi i veprimtarisë së Shoqërisë Konçesionare "Wonder Power" Sh.a.

"Wonder Power" Sh.a., do të ushtrojë aktivitetin e saj në Hidrocentralin "Bogovë" në Rrethin e Skraparit si dhe në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Fitimi

Fitimet që rezultojnë nga aktiviteti i shoqërisë do të ndahen mbasi të jenë zbritur detyrimet ndaj të tregëve dhe pasi të jete lënë shuma e fondit rezervë sipas përcaktimit në statut.

Neni 9

Forma juridike e "Wonder Power" Sh.a.

Forma juridike e shoqërisë do të jete Shoqëri Anonime pa oferte publike dhe emri i saj do të jete "Wonder Power" Sh.a., dhe në vazhdim do të referohet si "Wonder Power" Sh.a."

"Wonder Power" Sh.a., nuk është përgjegjëse për detyrimet e aksionerëve jashtë shoqërisë. Aksionerët i përballojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 10

Asambleja e Aksionerëve

Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Aksionerëve dhe vendimet e saj. Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve thirret një herë në vit. Kompetencat dhe përgjegjësit e Asamblese së Aksionerëve përcaktohen në statutin e shoqërisë.



Neni 11

Keshilli mbikqyres

Organi qe ushtron kontroll te vazhdueshem mbi aktivitetin e shoqerise eshte Keshilli Mbikqyres. Ai zgjidhet nga Asambleja e Aksionereve dhe perbehet nga :

1. Stavri Peci.
2. Silva Simaku.
3. Bamir Topi.
4. Ethem Ruka.
5. Engjell Skreli.
6. Kozeta Fino

Ne fillim te ushtrimit te aktivitetit shoqeria mund te rrise numrin e antareve te Keshillit Mbikqyres, per te siguruar pjesemarrjen ne masen 1/3 te tij nga ana e te punesuaresve. Ne rast se nuk rritet numri i antareve te Keshillit Mbikqyres, sigurimi i pjesemarrjes se te punesuaresve do te behet brenda numrit tre te anetareve te Keshillit Mbikqyres.

Kryetar i Keshillit Mbikqyres eshte Z. Stavri Peci

Sekretar i Keshillit Mbikqyres eshte Znj. Silva Simaku.

Kompetencat e Keshillit Mbikqyres dhe kryetarit te saj percaktohen ne statutin e shoqerise.

Neni 12

Drejtimi i shoqerise

Drejtimi i shoqerise kryhet nga Drejtori i Pergjithshem i saj qe eshte Zoti Sadik Llapashtica. Kompetencat, detyrat si dhe pergjegjesite e tij percaktohen ne Statutin e Shoqerise .

Neni 13

Dokumentimi ,aktet

Ne te gjitha aktet e shoqerise, dokumentat e saj te destinuara per te tretet, do te shenohen emrat e antareve te Keshillit Mbikqyres dhe te Drejtorit te Pergjithshem te saj.

Neni 14

Prishja e shoqerise

Shpallet ne mbledhjen e jashtezakonshme te Asamblese se Aksionereve.



"Wonder Power" Sha., priset automatikisht me mbarimin veprimtarise koncesionare ne HEC Bogove te Rrethit Skrapar.

"Wonder Power" Sha. mund te mbylle aktivitetin e tij perpara afatit te percaktuar ne kontrate kur :

- a) Asambleja e Aksionereve te shoqerise vendos per mbylljen .
- b) Aktiviteti rezulton me humbje per nje periudhe prej tre vitesh te njepasnjeshme.
- c) Kur kapitalet e veta behen me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar.

Ne raste tre mbylljes se aktivitetit ,ne cdo kohe ose per cdo arsye, Asambleja e Aksionereve cakton menyren e likuidimit te tij dhe emron nje ose me shume likuidatore, duke percaktuar fuqite dhe kompetencat.

Neni 15 **Pergjegjesia personale**

Pasuria e ortakeve, administratoreve, punonjesve dhe /ose agjenteve te shoqerise eshte e perjashtuar nga cdo lloj detyrimi qe rendon mbi "Wonder Power" Sha.

Neni 16 **Dispozitat e fundit**

Te gjitha shpenzimet qe do te kryhen deri ne regjistrimin e shoqerise si person juridik do te perfshihen ne bilancin ekonomik te shoqerise.

Pjese e pandare e aktit te themelimit eshte statuti, i cili do te nenshkruhet njeherazi nga aksioneret themelues te "Wonder Power" Sh.a.


Aksioneret jane te detyruar nga data e firmosjes te kryejne derdhjen e pjeses se kapitalit themeltar te shoqerise .

Kompetente per gjykimin e mosmarreshjeve qe lidhen me shoqerine anonime eshte Gjykata e Rrethit Tirane.


Ky akte themelimi u redaktua ne kater kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

A K S I O N E R E T

"Wonder" Sha.,
perfaqesuar nga
Vasil Gjika



Sadik Llapashtica




REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TI RANE

Nr. 8751 Rep.

Nr. 1709 Kol.


VERTETIM

Sot me daten 3 / 9 / 2003, ne zyren e Noterise Tirane perpara
meje Noteres Mimoza Shehu u paraqiten personalisht aksioneret e
shqerise «Wonder Power» Sha., te njohur personalisht prej meje, te
cilet deklaruan se sa siper eshte nje akt themelimi, i redaktuar sipas
vullnetit te tyre, e nenshkruan ne pranine time dhe une noterja legalizoj
nenshkrimet sipas ligjit.



STATUTI I SHOQERISE

"WONDER POWER" SHA.



Aksioneret e poshteshenuar,

1. "Wonder" Sha, e krijuar ne Vitin 2001 sipas Vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane Nr.25389 date 09.03.2001 me aksioner te vetem Zotin Vasil Gjika, i biri i Nikos, i lindur me 19.02.1955 ne Permet, mbajtes i pasaportes nr. 0165341, banues ne Tirane. Adresa e shoqerise : Rruga "Ismail Qemali" Qendra e Biznesit Kati III-te, Pallati perballe INIMA-s, Tirane.
2. Sadik Llapashtica, i biri i Rames, i lindur ne Fier me 20.01.1960, mbajtes i pasaportes nr. Z 151776, banues ne Tirane. Adresa : rruga "Ismail Qemali", Pallati 27/1, Ap. 1, Tirane.

kane themeluar shoqerine "Wonder Power" Sha., konform Aktit te Themelimit te kesaj shoqerise, te cilet deklarojne se kane hartuar si me poshte vijon Statutin e Shoqerise Anonime pa oferte publike te emertuar "Wonder Power" Sha., te themeluar prej tyre.

Shoqeria fiton personalitetin Juridik nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane. Ajo eshte person juridik shqiptar dhe e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe ato te akteve te tij themeluese (Statuti dhe Akti i Themelimit te Shoqerise).

KREU I

OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE, KOHEZGJATJA


Neni 1

Bazueshmeria Juridike

Veprimtarine e tij Grupi i Konsulences do ta zhvilloje ne baze te ketij statuti dhe te neneve 74-77, 89-93, 96-210 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", veç atyre paragrafeve apo neneve qe nuk kane te bejne me kete forme shoqerise, si dhe te te gjithe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 2

Objekti i veprimtarise

 Shoqëria Wonder Power" Sh.a., ka për objekt kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe /ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryej një shoqëri anonime në baze të legjislationit shqiptar dhe në veçanti :

- Prodhimi energjise elektrike duke shfrytëzuar burimet e energjise të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme, si ajo hidrike, diellore, e erës, gjeotermale, e biomases ose biogazit si dhe energjia nga mbetjet urbane.
- Projektimi dhe studimi i hidrocentraleve, termocentraleve apo impianteve të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjise që gjenden në natyrë dhe që janë të rinovueshme.
- Ndertimi i hidrocentraleve, termocentraleve apo impianteve të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjise që gjenden në natyrë dhe që janë të rinovueshme.
- Shitja e energjise elektrike klienteve. dhe blerja e energjise elektrike nga operatore të ndryshëm privat apo shtetëror brenda dhe jashtë vendit.
- Transmetimi i energjise elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.
- Përdorimin e sistemeve të linjave, strukturave mbështetëse dhe pajisjesh, transformuese e kontrolluese për transmetimin e energjise elektrike.
- Operator i sistemit të transmetimit për të kryer aktivitetin e transmetimit të energjise elektrike dhe të dispeçerimit (axhustim ose rregullimi i prodhimit të energjise elektrike sipas kërkesave të konsumit, në nivel kombëtar.
- Shpërndarjen, transportin e energjise elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit, të mesëm dhe të ulët, duke patur parasysh shpërndarjen deri tek konsumatori i fundit.

Neni 3

Vendodhja e selisë së "Wonder Power" Sh.a

"Wonder Power" Sh.a. do të ketë selinë e saj në Tiranë, Rruga "Ismail Qemali" Qendra e Biznesit Kati III-të. Ajo mund të hapë edhe zyrë përfaqësie, dege të krijojë filiale filiale dhe/ose të realizojë çdo lloj pjesëmarrje të parashikuar nga ligji në shoqëri të tjera, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë "Wonder Power" Sh.a

Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë "Wonder Power" Sh.a. do të jetë 30 vjet. Si ditë e fillimit të aktivitetit të tij do të merret data e regjistrimit në Gjykatën e Tiranës. Aksionerët e shoqërisë kanë të drejtë të zgjasin këtë afat.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET

Neni 5
Kontributet ne kapital

Ne momentin e themelimit, Shoqerise i jane sjelle si kontribut ne para nje shume prej 2.000.000 (dymilion) leke qe i pergjigjet vleres nominale te aksioneve Nr. 1 deri ne 100, te gjitha ne para qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise. Aksionet jane te pandashme. Kapitali eshte i ndare ne 100 aksione ,me vlere nominale 20.000 leke sejcili aksion. Keto aksione jane neshkruar teresisht dhe jane shlyer teresisht nga :

Nr	Emri Mbiemri	Nr Aksioneve	Vlera Nominale	Kontributi ne Para
1	"Wonder"Sh.a perfaq., nga Vasil Gjika	1 - 55	20 000	1.100 000 leke.
2	Sadik Llapashtica	56-100	20 000	900 000 leke.

Te cilet jane te vetmit persona firmoses te ketij statute. Shuma e derdhur nga aksioneri eshte ne natyre dhe e depozituar ne banke ose prane ndonje noteri dhe derdhjet jane evidentuar me nje certifikate te hartuar ne pajtim me ligjin.

Neni 6
Kapitali i Shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2.000.000 (dymiljon) leke. Kapitali ndahet ne 100 aksione, me vlere nominale 20.000 leke sejcili teresisht i derdhur dhe i numeruar nga 1-100. Kapitali aksioner mbulohet ne perqindje si me poshte :


Nr.	Emri Mbiemri	Ne perqindje (%)
1	"Wonder"Sh.a., perfaqesuar nga Vasil Gjika	55
2	Sadik Llapashtica	45

Neni 7
Ndryshimi i kapitalit themeltar

A). Zmadhimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve behet vetem me pelqimin unanimit te aksionereve, me perjashtim te rastit kur ai realizohet me perfshirjen e rezervave, te fitimeve apo primeve te emetimit. Kapitali themeltar zmadhohet nepermjet :

1. Emetimit te aksioneve te reja ose ;



2. Rritjes se vleres nominale te aksioneve ekzistuese.
Aksionet e reja shlyhen me para ne dore. Aksioneret kane te drejte perparies ne pënskrimin per rritjen e kapitalit me para ne dore proporcionalisht me shumen e aksioneve qe zoteron. Çdo klauzole e kundrt eshte e pavlefshme.
Zmadhimi i kapitalit themeltar duhet te realizohet brenda 5 vjeteve nga dita qe aksioneret e kane miratuar kete zmadhim (Neni 153, Ligji Nr. 7638 date 19.11.1992).

B). Zvogelimi i kapitalit

Zvogelimi i kapitalit autorizohet ose vendoset nga Asambleja e Jashtezakonshme ne mbledhjen e saj.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek aksioneret ne te njejten mase ne perpjestim me vleren e aksioneve qe zoterojne.

Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar, te pakten 45 dite perpara mbledhjes se asamblese se aksionereve qe thirret per te vendosur mbi kete projekt.

Neni 8

Shlyerja dhe verifikimi i kapitalit

Nuk mund te merret vendim dhe te realizohet zmadhimi i kapitalit aksionar me para ne dore nese kapitali aksionar i deritanishem nuk eshte shlyer plotesisht. Ne rast te kundert operacioni i zmadhimit te kapitalit dhe leshimit te aksioneve te reja konsiderohet i pavlefshem ne baze te nenit 153 te Ligjit 7638 date 19.11. 1992. Keshilli mbikqyres, ne çdo rast te zmadhimit te kapitalit , duhet qe ne nje afat tre mujor nga realizimi i zmadhimit te kapitalit te verifikoje depozitimin e kapitalit. Nse kapitali nuk eshte mbuluar plotesisht, atehere Keshilli Mbikqyres diponon lirshem aksionet e pambuluara tek te tretet ose kapitali aksionar shtohet deri ne shumen e mbulimit te tij.

KREU III

AKSIONET

Neni 9

Aksionet paraqiten ne formen e aksioneve nominative dhe jane te formes emerore.

Neni 10

Aksionet jane te tregtueshme vetem me pelqimin e Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve.

Neni 11

Me perjashtim te rasteve te trashegimise, aksionet tregtohen brenda shoqerise, duke ju shperndare aksionereve te tjere ne pjese te barabarta per te ruajtur raportet. Ne te gjitha rastet, kur behet bleja e tyre nga aksioneret e tjere te shoqerise,

vleresimi i aksioneve do te behet nga nje ekspert i cili caktohet me mirekuptim nga palet. Ne rast se nuk bihet dakord, ai caktohet me vendim te gjykates. Ndryshimi i pronesise se aksioneve si rrjedhoje e nje shitje ose transferimi behet ne baze te nje urdher-kalimi ne regjister.

Neni 12

Transferimi i pronesise mbi aksionet tek nje person joaksionar, kur nuk realizohet legjitimi sipas nenit 11 te ketij statute, pavaresisht nga baza juridike e ketij transferimi, duhet te miratohet me konsensus nga Keshilli Mbikqyres dhe Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve.

Neni 13

Aksionet jane te pandashme kundrejt shoqerise e cila njej vetem nje pronare kryesor te nje aksioni. Çdo aksion jep te drejten e nje vote. Nje aksion nuk mund te kete me shume se nje zoterues.

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga çdo aksion i ushtron vetem pruresi i tij i ligjshem.

Aksioneret jane pergjegjes deri ne kufirin e vleres nominale te kaisoneve qe zoterojne.

Çdo kerkim fondesh pertej ketij kufiri eshte i ndaluar.

Çdo aksion i jep te drejten zoteruesit te tij te drejten e marrjes se nje pjese nga fitimet e shoqerise ne perpjestim me kuoten -pjese te kapitalit qe ai perfaqeson, si dhe i jep zoteruesit te tij te drejten e votes dhe te perfaqesimit.

Aksioneri ushtron te drejtat e tij persa i perket Drejtorit te Shoqerise nepermjet Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve.

KREU IV

ORGANET E SHOQERISE

Shoqeria drejtohet, organizohet dhe administrohet nga organet e tij qe jane Asambleja, Keshilli Mbikqyres dhe Drejtoria.

Neni 14

ASAMBLEJA

Asamblete mund te thirren si ne Seline e shoqerise ashtu edhe ne vende te tjera, si ne territorin e Shqiperise. Asambleja e zakonshme duhet te thirret se paku nje here ne vit brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor. Thirrja e asamblese behet nga nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres, i cili eshte i detyruar te marre masat e duhura mbi kerkesen e se paku dy anetareve te Keshillit Mbikqyres, ose nga Drejtori i Pergjithshem ose nga personat e treguar ne artikullin 132 te ligjit nr.7638, 19/09/1992. Thirrja e asamblese kryhet nepermjet nje njoftimi te aksionereve te shoqerise me leter rekomande.

Asamblete drejtohen nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres, ose ne mungese apo ndalim te tij, nga Sekretari i Keshillit Mbikqyres. Asamblea emerone nje sekretar, pervec se kur proces-verbali redaktohet nga nje noter.

Aksioneri mund te perfaqesohet ne asamble, sipas percaktimit ne ligj dhe delegimi mund te shkruhet mbi nje model te pranuar nga asamblea.

Asamblete jane te zakonshme dhe te jashtezakonshme. Asamblea e zakonshme aprovon bilancin vjetor, vendos mbi destinacionin e fitimeve, emeron anetaret e Keshillit Mbikqyres dhe vendos mbi te gjithë objektet e tjere qe kane te bejne me drejtimin e shoqerise, te cilat ligjit ia rezervon asaj per kompetence, si dhe ato qe paraprakisht shqyrtohen nga Drejtoria ose Keshilli Mbikqyres.

Asamblea e jashtezakonshme thirret per vendimet qe kane lidhje me ndryshimet e Aktit te Themelimit dhe te Statutit, si dhe per vendimet e tjera te kompetences se saj sipas ligjit ose kur Keshilli Mbikqyres ose Drejtoria i konsiderojne te nevojshem.

Asamblea e jashtezakonshme me thirrjen e pare konsiderohet e rregullt me prezencen e te dy aksionereve. Ajo merr vendim me nje shumice votash prej $\frac{2}{3}$ qe u perkasin aksionereve te pranishem.

Vendimet e asamblese merren gjithmone me vota te hapura, duhen te pasqyrohen ne proces-verbalin e nenshkruar nga kryesuesi dhe nga sekretari ose nga noteri, sipas rastit kur jane te zakonshme apo te jashtezakonshme. Ne proces-verbale pasqyrohen ne menyre te permblledhur deklarimet e aksionereve, sipas kerkeses se bere prej tyre. Proces-verbalet redaktohen ne gjuhen shqipe, me vlere te barabarte per efektet juridike te tyre.

Proces-verbalet e asambleve shkruhen ne libra te posaçem dhe duhet te firmosen nga kryesuesi dhe sekretari ose nga noteri.

Kryesuesi i asamblese ka fuqi te plota per te verifikuar regullsine e mbledhjes dhe ne pergjithesi, te drejten e aksionereve per te marre pjese ne te, per te konstatuar vlefshmerine e asamblese, per te drejtuar dhe rregulluar diskutimet dhe per te vendosur menytrat e votimit.

Neni 15 KESHILLI MBIKQYRES

Keshilli mbikqyres perbehet nga nje minimum antaresh prej tre personash, te cilet mund te mos jene ortake. Anetaret e keshillit mbikqyres nuk mund te jene administratore te saj. Ata kane nje mandat me kohezgjatje dy vjet dhe mund te rizgjidhen. Asamblea percakton shperblimet e tyre.

Keshilli mbikqyres, nese asamblea nuk parashikon, zgjedh ndermjet anetareve te saj nje Kryetar dhe nje zv/Kryetar dhe emeron nje sekretar. Ky i fundit mund te mos jete anetar i keshillit.

Keshilli mbikqyres thirret dhe drejtohet nga kryetari ose ne mungese te tij nga zv/kryetari. Keshilli mbikqyres mblidhet ne seline e shoqerise.



Keshilli mbikqyres konsiderohet se eshte mbledhur ne menyre te vlefshme me prezencen e shumices se anetareve te tij dhe vendimet e marra jane te vlefshme nese jane marre me shumicen e votave te pranishmeve; ne rast te barazise se votave, ajo e kryetarit te Keshillit Mbikqyres ose te atij qe e zevendeson eshte dominuese. Te gjitha vendimet e keshillit duhet te pasqyrohen nga nje proces-verbal i nenshkruar nga kryetari ose ai qe e zevendeson dhe nga sekretari. Proces-verbalet redaktohen ne gjuhen shqipe.

Keshillit Mbikqyres i atribuohen pushtetet e percaktuara ne baze te ligjit.

Keshilli Mbikqyres perbehet nga tre anetare, te cilet jane emeruar me nje mandat me kohezgjatje prej dy vjetesh, prej personave ne vazhdim :

1. Stavri Peci, i biri i Petros, i lindur ne Korçe, me 23.08.1945, banues ne Rruga "Haxhi Dalliu", Pallati perballe Prokurorise, Shkalla 3, Ap.6, Tirane, Kryetar.
2. Silva Simaku, e bija e Eduardid, lindur ne Tirane, me 05.08.1963, me banim ne Rruga "Myslym Shyri", Pallati 47/1, Ap.11, Tirane, mbajtese e pasaportes nr. 0043332, Sekretare.
3. Bamir Topi.
4. Ethem Ruka.
5. Engjell Skreli.
6. Kozeta Fino.

Neni 16 DREJTORIA

Shoqeria "Wonder Power" Sha., administrohet nga nje Drejtoria. Anetaret e Drejtorise kane nje mandat me kohezgjatje prej 2 vjete dhe rizgjidhen.

Mbledhja e Drejtorise thirret nga Drejtori i Pergjithshem, dhe drejtohet nga Drejtori i Pergjithshem ose nga anetari me i vjeter i saj. Drejtoria thirret ne seline e shoqerise.

Vendimet e Drejtorise merren me shumicen absolute te votave; ne rast te barazise se votave ajo e Drejtorit eshte dominante. Te gjitha vendimet e Drejtorise duhet te pasqyrohen ne nje proces-verbal te nenshkruar nga Drejtori i Pergjithshem dhe nga sekretari. Proces-verbalet redaktohen ne gjuhen shqipe.

Perfaqesimi i shoqerise i takon vecanerisht Drejtorit.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres dhe te Drejtorise duhet te permbushin detyrat e tyre te percaktuara nga ligji dhe nga akti i themelimit, me kujdesin e perfaqesuesit dhe jane solidarisht pergjegjes ndaj shoqerise per demet e shkaktuara nga mosplotesimi i tyre, perverse kur trajtohen si attribute te percaktuara te nje apo disa anetareve te Drejtorise. Ne cdo rast, anetaret e Drejtorise jane solidarisht pergjegjes nese nuk kane kontrolluar mbi ecurine e pergjitheshme te drejtimit dhe se, duke qene ne dijeni te veprimeve qe e

demtojne shoqerine, nuk kane bere ate qe duhej te benin per eleminimin e tyre ose per te zbutur efektin demtues te tyre. Pergjegjesia per veprimet apo mosveprimet e anetareve nuk shtrihet per ate qe nder te tjeret, i perjashtuar nga faji, ka shenuar pa vonese mosaprovimin e tij ne librin e Drejtorise dhe ka njoftuar menjehere Keshillin Mbikqyres.

Anetaret e Drejtorise pergjigjen ndaj kreditorëve te shoqerise per mospembushjen e detyrimeve qe kane lidhje me ruajtjen e paprekshmerise se pasurise se shoqerise.

Drejtor i Pergjithshem i shoqerise eshte Z. Sadik Llapashtica, i biri i Rames, i lindur ne Fier me 20.01.1960, mbajtes i pasaportes nr. Z 151776, banues ne Tirane. Adresa : rruga "Ismail Qemali", Pallati 27/1, Ap. 1, Tirane.

KREU V

Bilanci dhe ndarja e fitimeve

Neni 17

Vitet ushtrimore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti.

Neni 18

Me mbylljen e çdo viti ushtrimor, drejtoria do te redaktoje inventarin me kriteret te percaktuar me shume kujdes dhe ne baze te atyre te percaktuara nga ligji, si dhe do te hartoje brenda afateve ligjore, bilancin e vitit ushtrimor me llogarite e perfitimeve dhe te humbjeve, per t'ia paraqitur per miratim Keshillit Mbikqyres dhe asamblese.

Neni 19

Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci, duke zbritur 5 perqind te tyre, te destinuare per t'i vendosur ne fondin e rezerves ligjore, derisa ky fond te arrije ne masen e 10 perqind te kapitalit themeltar, do te ndahen ndermjet aksionisteve, pervecse kur asamblea e zakoneshme vendos ndryshe.

KREU VI

Neni 20

Eksperti kontabel i autorizuar


Kontrolli kontabel kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i cili emerohet çdo vit nga asamblea e ortakeve ne baze te ligjit shqiptar.

Ekspert Kontabel eshte Z. Berti Pashko.

KREU VII

Neni 21

Likujdimi



Ne rastin e prishjes se shoqerise, asamblea do te emeroje nje ose disa likuidatore, te cilet do te veprojne ne baze te ligjit.

KREU VIII

Neni 22

Mosmarreveshjet

Çdo mosmarreveshje qe do te mund te lindin ndermjet shoqerise dhe aksionereve, anetareve te Drejtorise, anetareve te Keshillit Mbikqyres, likuidatoreve dhe te gjithë personave te tjere te permendur ne kete statut, do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

KREU IX

Dispozita Perfundimtare

Neni 23

Per gjithcka qe nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut, do te zbatohen ne referim dispozitat e ligjit nr.7638, date 19.12.1992 "Per shoqerite tregtare", ato te Kodit Civil dhe ligjeve te tjera ne fuqi, ne lenden e shoqerive me aksione.

Neni 24

Ky statut eshte redaktuar ne gjashte 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

AKSIONERET

"Wonder" Sha.
perfaqesuar nga

Vasil Gjika

Sadik Llapashtica

